



Buletini nr. 160- Mars- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Buletini nr. 160- Mars- 2017- Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë shënimit të “Epopeja e UÇK”-së



Përmbajtja:

Filloi hapja e një rrugë në Lubizhdë	4
KPF e rekomandoi për kuvend, raportin e komisionit për ankesat në emërtimin e rrugëve.....	4
Karitasi zviceran, do të përkrahë arsimin parafillorë në Malishevë	5
Malisheva, po shënon manifestimin “Epopeja e UÇK-së”	6
Në ditën e 7 Marsit, nënshkruhet marrëveshja me Caritas-in Zviceran për përkrahje në edukimin parashkollor	7
Shkollat e Malishevës dhe Shqipërisë, shënuan bashkë 7 Marsin	8
Mustafa e Begaj, biseduan për vazhdimin e trajtimit të etheve hemorragjike.....	9
Me 8 Mars, u nderuan me mirënjohje familjet e dëshmorëve dhe gratë e suksesshme në Malishevë.....	10
Së shpejti pritet hartimi i planit të integritetit.....	11
KK nuk miratoi punën e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emrat e rrugëve.....	12
Filloi fushata e repelimit të kafshëve.....	12
Karamarinov: FAE do të përkrahë ndërtimin e shtegut të atletikës në Malishevë.....	13
Ka filluar ndërtimi i rrugës, që do të shërbej si transit	14
Njësia e shpëtimit, testoi barkën e shpëtimit dhe demonstroi shkathtësitë e veta	15
Po vazhdojnë vizitat sistematike shëndetësore në shkollat e Malishevës.....	16
Morina: Janë duke u realizuar dhjetëra projekte	17
Begaj e Basha, diskutuan për një ambient më të pastër	18
KPF, mbajti mbledhjen e katërt të radhës	18
Begaj, takoi banorët e Ploqicës së Epërme.....	19
Begaj, priti në takim pune, zyrtarët e CMIC-ut (KFOR) italian	19
Kryetari Begaj, vizitoi tregun në Malishevë	20
Sot, përfunduan vizitat sistematike shëndetësore në shkollat e Malishevës	21
Hoxha: Gratë fermere do të kenë përparësi në subvencionet e komunës	22
Begaj: Do të përkrahim organizimet sportive në shkolla.....	23
Asfaltohen rrugët në Pagarushë	23



Ka filluar pastrimi i një dege të lumit Mirusha	24
Nesër fillojnë ligjëratat mbi mbrojtjen nga thumbimi i rriqrave	25
Asfaltohet rruga që lidhë fshatrat Marali dhe Maxharrë	25
Filloi ndërtimi i urës mbi lumin Mirusha.....	26
Asfaltohen rrugët në disa lagje të Banjës	26
U përkujtua masakra e Burimit.....	27
Kryetari Begaj, priti një grup biznesmenësh nga Ankaraja.....	28



Filloi hapja e një rrugë në Lubizhdë

Malishevë, 1 mars



Ka filluar hapja e një rruge të re në fshatin Lumbizhdë të Komunës së Malishevës, rrugë e cila do ti lidhë disa lagje dhe një pjesë të madhe të fshatit, me rrugën Malishevë-Kijevë, me shkollën e fshatit dhe me ambulancën. Punimet në këtë rrugë, sot i ka inspektuar drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, i cili edhe është takuar me disa nga banorët e fshatit, të cilët i ka uruar për rrugën e re.

Me këtë rast, drejtori Morina, përveç urimeve për banorët e fshatit, tha se “punimet janë duke u kryer mirë dhe rruga do të vazhdoj deri në përfundimin e saj”. Kjo rrugë e re, që po hapet, sipas Morinës, do të jetë në tërësi në shërbim të qytetarëve, por ne veçanti për nxënësit, të cilët, ose duhet të udhëtojnë më gjatë nga shtëpitë deri në shkollë, ose e bartin baltën dhe pluhurin brenda shkollës.

Rruga ka një gjatësi prej rreth 700 metrave dhe fillon nga shiriti i rrugës Malishevë-Kijevë, përkatësisht mes ambulancës së fshatit dhe shkollës dhe lidhet me lagjet brenda fshatit. Kjo rrugë financohet nga Komuna e Malishevës. Rrug është tërësisht e re, pra është duke u punuar në hapjen e saj, mbushjen dhe në fund do të asfaltohet.

Përndryshe kjo rrugë, përveç që do të jetë në shërbim të nxënësve, ka rëndësi të madhe për një pjesë të fshatit, të cilët në rastet e përmbytjeve të lumit Mirusha, këtë rrugë e shfrytëzojnë për të qarkulluar nga shtëpitë e tyre, deri në rrugët kryesore.

KPF e rekomandoi për kuvend, raportin e komisionit për ankesat në emërtimin e rrugëve



Malishevë, 1 mars

Komiteti për Politikë dhe Financa, i drejtuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, Aiziz Thaci, dje ka mbajtur mbledhjen e tretë të komitetit, ku pikë e vetme e rendit të ditës ishte, shqyrtimi i raportit të komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, në territorin e Komunës së Malishevës.

Para anëtarëve të komitetit, ka raportuar Rrahim Morina, udhëheqës i këtij komisionit të formuar nga ana e Kuvendit të Komunës. Sipas Morinës, komisioni ka pasur një punë të vështirë, të mundimshme, ku vështirësitë janë paraqitur tek ankesat, për vendosjen e emrave të familjarëve.

Sipas tij, komisioni ka trajtuar të gjitha ankesat e qytetarëve, si dhe kanë mbajtur takime me kryesitë dhe kryetarët e të gjitha vendbanimeve.

Pas shqyrtimit të këtij raporti nga ana e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, raporti i këtij komisioni, është rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, ku edhe përfundimisht do të merret vendimi për emrat e kontestuar nga ana e qytetarëve, pasi emërtimi i rrugëve, është përgjegjësi e Kuvendit të Komunës.

Karitasi zviceran, do të përkrahë arsimin parafillorë në Malishevë

Malishevë, 2 mars

Karitas zviceran, do të përkrahë arsimin parafillorë në Malishevë, përkatësisht me inventar për klasat e këtij niveli. Ko është bërë e ditur në takimin mes zyrtarëve të Karitasit dhe Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë. DKAE në Malishevë, ka konfirmuar se do të investohet në tetë klasa të arsimit parafillorë.

Përveç inventarit, duke u bazuar në njoftimin e dhënë nga drejtori i arsimit, Avdi Morina, pas takimit me Albert Bakalli, zyrtar i Karitasit, në kuadër të kësaj përkrahje, do të trajnohen edhe edukatorët që japin mësim në këtë cikël të arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë.

Sipas drejtorit të arsimit, Avdi Morina, kjo nuk hera e parë, por Karitasi zviceran, në vazhdimësi e ka përkrahur arsimin në Malishevë, përkatësisht nivelin parafillorë dhe “Komuna e Malishevës,



e çmon dhe e vlerëson lartë Kartitasin zviceran për këtë përkrahje të vazhdueshme dhe kontributin në arsim”.

Morina, ka deklaruar se ky projekt i Karitasit zviceran, pritet të filloj shumë shpejt, ndërsa përmes kësaj, synohet krijimi i kushteve sa më të mira për nxënësit e arsimit parafillorë.

Malisheva, po shënon manifestimin “Epopeja e UÇK-së”

Malishevë, 6 mars



Në kuadër të shënimit të manifestimit “Epopeja e UÇK-së” , Komuna e Malishevës, përmes aktiviteteve të ndryshme, po shënon këto data me rëndësi në historinë e popullit shqiptar. Në kuadër të këtyre shënimeve, Kuvendi i Komunës së Malishevës, sot ka mbajtur një seancë solemne, ndërsa janë bërë nderime pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe

në Prekaz.

Në seancën solemne, të Kuvendit të Komunës, krahas anëtarëve të KK-së dhe familjeve të dëshmorëve, morën pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti, komandanti i stacionit policor në Malishevë, Halil Morina, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, dhe të tjerë.

“Ngjarja e 5, 6 dhe 7 Marsit, të vitit 1998, ishte dhe do të mbetet njëra prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar, sepse pas kësaj ngjarje u bë kthesa e madhe historike”, tha kryetari Begaj, në fjalën e tij, ndërsa duke folur për sakrificën e familjes Jashari, Begaj tha se “Kjo sakrificë e një familjeje, është rasti më unik në botë, i një sakrifice të një familjeje, të cilët ranë për çështjen kombëtare”. Në fjalën e tij, kryetari Begaj, e përmendi edhe ish kryeministrin e vendit Ramush Haradinaj dhe luftëtarët tjerë të lirisë, të cilët, po mbahen padrejtësisht në burgje.



Ndërsa një fjalë rasti e ka mbajtur edhe kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaçi, i cili foli për sakrificën e familjes Jashari, rëndësinë e kësaj ngjarje dhe ndikimi i saj në rrjedhat e mëtutjeshme të historisë. “Sakrifica e familjes Jashari, ishte një histori në vete, e cila i fliste popullit shqiptar dhe botës demokratike, se populli shqiptar e ka nisur shtegtimin e saj për liri, të cilën nuk mund ta ndalë askush”, tha mes tjerash kryesuesi Thaçi, i cili shprehi mirënjohje edhe për të gjithë dëshmorët e kombit dhe të gjithë mësuesit e rënë në luftën për liri.

Një fjalë rasti e ka mbajtur edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti, i cili tha se “sot është një datë, kur të gjithë duhet të jemi të bashkuar, pa marrë parasysh bindjet. Sot jemi para një sfide të madhe, kur vendi ynë po përballet me rreziqe të vazhdueshme, përfshi edhe integritetin territorial dhe kushtetutshmërinë, dhe këto janë sfida të cilat duhet të na mbajnë të bashkuar”.

Fjalë rasti ka mbajtur edhe përfaqësuesi i familjeve të dëshmorëve në Malishevës, Sinan Gegaj.

Më pas, janë bërë nderime para shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në sheshin e dëshmorëve në Malishevë, homazhe në varrezat në Malishevë dhe Kleçkë, si dhe në Prekaz, ndërsa është bërë një vizitë edhe në odën e madhe të Jasharajve në Prekaz.

Në ditën e 7 Marsit, nënshkruhet marrëveshja me Caritas-in Zvicëran për përkrahje në edukimin parashkollor

Malishevë 7 mars

Sot në ditën e mësuesit, është nënshkruar marrëveshja mes Caritas-it Zvicëran dhe Komunës së Malishevës, për përkrahje në sistemin parashkollor të arsimit. Marrëveshja është nënshkruar mes Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, shefit të zyrës së Caritas-it Zvicëran në Kosovë, Kreshnik Basha, drejtorit për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina dhe përgjegjësit të këtij projekti Albert Bakallit. Në këtë takim, mori jesh edhe trajnere-delegate e Caritas-it Zvicëran, Erika Masina.





Mbështetja dhe përkrahja e komunës me Caritas-in Zviceran, në edukimin parashkollor, është treguesi i rëndësisë që Komuna e Malishevës, i jep edukimit parashkollor, si parakusht për përgatitjen më të mirë të fëmijëve.

“Caritas-i Zviceran, ka një bahskëpunim tejet të mirë me Komunën e Malishevës dhe kjo është arsyeja e ripërtëritjes së kësaj marrëveshje, dhe për neve është një kënaqësi e madhe, që po bëhet kjo marrëveshje për përkrahje në edukimin parashkollor”, tha Kreshnik Basha, shef i zyrës së Caritas-it Zviceran në Kosovë.

Nga an tjetër, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka falënderuar Caritas-in Zviceran, për këtë përkrahje dhe për bashkëpunimin e mirë me Komunën e Malishevës, ku nga kjo marrëveshje, po përfitojnë fëmijët, të cilët janë të inkuadruar në klasat parashkollore dhe kjo është një ndihmesë e madhe për arsimin në Malishevë.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, Caritas-i Zviceran, do të ndihmoj në pajisjen e klasave të arsimit parashkollor si dhe trajnimin profesional, në përputhje standartet e edukimit parashkollor.

Shkollat e Malishevës dhe Shqipërisë, shënuan bashkë 7 Marsin

Malishevë, 7 mars



mësimdhënësit më të mirë.

7 Marsi, Dita e Mësuesit, është shënuar sot në Komunën e Malishevës, ndërsa në këtë shënim, mori pjesë edhe shkolla tetëvjeçare “Tahir Sinani” nga Paskuqani, Bashkia e Tiranës, shkollë e binjakëzuar me Sh.F.M.U. “Ibrahim Mazreku” në Malishevë. Në këtë shënim, mësuesit i ka uruar Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ndërsa gjatë aktivitetit qendrorë janë shpallur edhe



Fillimisht, të pranishmit në aktivitetin qendrorë të mbajtur në shtëpinë e kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë, mësuesit he veteranët e arsimit, i ka uruar drejtori komunal i arsimit, Avdi Morina, i cili foli edhe me për rrugëtimin e shkollës shqipe, nga hapja e shkollës së parë në Korçë, e deri më sot, me theks të veçantë në Komunën e Malishevës.

Më pas, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i ka uruar të gjithë mësimdhënësit e Komunës së Malishevës, si dhe mësimdhënësit nga Shqipëria, të cilët ishin prezent. Begaj, e ka vlerësuar lartë punën dhe kontributin e mësimdhënësve të shkollës shqipe, si dhe foli me admirim për ish mësimdhënësit e tij.

Një fjalim rasti e ka mbajtur edhe Thanasi Anastasi, drejtor i shkollës tetëvjeçare “Tahir Sinani” në Paskuqan, i cili gjithashtu i përshëndeti të gjithë mësimdhënësit, si dhe Komunën e Malishevës, për këtë organizim me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit.

Në këtë aktivitate, janë ndarë edhe shpërblime, për mësimdhënësit, më të mirë të Komunës së Malishevës të cilët janë shpallur nga shkollat ku ata punojnë, ndërsa edhe Drejtorja për Arsim dhe Edukim në Malishevë, duke u bazuar në rezultat e tyre, i ka shpallur mësimdhënësit më të mirë, në të gjitha ciklet e arsimit në nivel komunal.

Duke u bazuar në rezultatet e arritura, Drejtorja për Arsim dhe Edukim, mësimdhënësin më të mirë e ka shpallur, profesorin e lëndës së kimisë, në gjimnazin “Hamdi Berisha” në Malishevë, prof.Shefqet Zogaj, ndërsa mirënjohjen, e ka ndarë i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Mustafa e Begaj, biseduan për vazhdimin e trajtimit te etheve hemorragjike

Prishtinë, 7 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Hajdin Berisha, janë takuar sot në Prishtinë, me Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, me të cilin kanë biseduar për vazhdimin e trajtimit të etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), edhe gjatë vitit 2017. Kryeministri Mustafa, ka premtuar se do angazhohet, që Ministria e Bujqësisë, të kryej obligimet, sipas strategjisë nacionale për parandalimin dhe luftimin e EHKK.

Pas takimit, kryetari Begaj, ka konfirmuar, se në takim kanë biseduar lidhur me EHKK dhe se kanë kërkuar nga kryeministri i vendit, që të angazhohet, që Ministria e Bujqësisë të kryej obligimet, bazuar në strategjinë nacionale për luftimin dhe parandalimin e EHKK.



Kërkesa për trajnimin e EHKK, ka ardhur, pasi në takimin e Këshillit Ndërmintor për trajtimin e EHKK, nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, është e bërë e ditur se nuk kanë ndarë fond për spërkatjen e zonave endemike.

Përndryshe, në takimin e sotëm, Begaj e Mustafa, kanë biseduar edhe për çështje tjera, përkatësisht për projekte tjera, me interes për Komunën e Malishevës.

Me 8 Mars, u nderuan me mirënjohje familjet e dëshmorëve dhe gratë e suksesshme në Malishevë

Malishevë, 8 mars



Sot, organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës dhe Grupi Joformal i Grave asamblete në KK të Malishevës, përmes një organizimi me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, kanë ndarë mirënjohje për familjet e dëshmorëve, si dhe për gratë më të suksesshme ndër vite dhe gjatë vitit 2016, në fushat e ndryshme të jetës.

Në këtë takim, mori pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, i shoqëruar nga drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi dhe drejtor tjerë të qeverisë komunale, deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti dhe komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiten Halil Morina.

“Malisheva po e kultivon frymën e barazisë gjinore”, tha në fjalën e tij kryetari Begaj, i cili më pas vlerësoi lartë kontributin e nënave dhe femrave në luftën e fundit dhe në të gjitha zhvillimet e tjera, përfshi edhe kontributin e zhvillimit të shoqërisë dhe zhvillimit ekonomik. “Femra shqiptare ka merita të mëdha në historinë e popullit shqiptar”, tha në fund Begaj dhe i uroi të gjitha nënat dhe gratë e Komunës së Malishevës.

Ndërsa deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoti, e vlerësoi 8 Marsin, si një ditë të rëndësishme ndërkombëtare, ditë e cila jep mundësi që të bashkohen gratë, pa dallime. “Në lirinë që sot ne e gëzojmë, femrat shqiptare kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, por kjo liri nuk ka kuptim dhe nuk është liri, pa të drejta të barabarta”, tha Hoti.



Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës, Vera Bytyçi, duke mbajtur një fjalim, bëri thirrje për barazi gjinore dhe respektim të ligjeve, me të cilat garantohen të drejtat e barabarta. “Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe të qëndrueshme”, tha Bytyçi.

nga një fajël rasti, kanë mbajtur edhe kryetarja e grupit joformal të grave në KK, Behije Sertolli, anëtarja e LDK-së në KK të Malishevës, Filloreta Bytyçi, anëtarja e VV-së në KK të Malishevës, Jetmira Vrenezi dhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi.

Në fund të këtij aktiviteti, janë ndarë nëntë mirënjohje për familjen e Liman Gegaj, dëshmor i kombit, familjen e Mentor Gashit, dëshmor i kombit. Mirënjohje janë ndarë edhe për kontribut në kujdesin shëndetësor, për Sanije Deskun dhe Bukurije Zogajn, për promovim të të drejtave për personat me aftësi të kufizuara, Feride Hoxha, për kontribut në emancipimin dhe edukimin e femrës, veteranet e arsimit Xhezide Krasniqi dhe Kumrije Lushtaku. Mirënjohje janë ndarë edhe femrat e suksesshme në biznes, e kësaj radhe, mirënjohje është ndarë për Shqipe Kastratin dhe Selvishahe Sertollin.

Së shpejti pritet hartimi i planit të integritetit

Malishevë, 9 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot zyrtarin e “Uboconsulting”, Valon Feka, me të cilin janë dakorduar për fillimin e hartimit të planit të integritetit për Komunën e Malishevës. Përmes këtij plani, synohet ofrimi i shërbimeve më transparente dhe më efikase, ndërsa ky është një projekt i UNDP, që implementohet nga “Uboconsulting”.

Për këtë qëllim, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka formuar edhe një ekip që do të trajnohet dhe më pas të merret me hartimin e planit të integritetit. Ky plan është një dokument strategjik dhe operativ, që del nga procesi i vlerësimit të rreziqeve të mundshme.

Plani rithekson përkushtimin e komunës për të shtuar më tej kontrollet ekzistuese operative në të gjithë gamën e aktiviteteve të kryera, me fokus në ofrimin e shërbimeve transparente dhe efikase. Përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të saja të integritetit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.



KK nuk miratoi punën e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emrat e rrugëve

Malishevë, 13 mars

Kuvendi i Komunës së Malishevës, nën drejtimin e kryesuesit Aziz Thaci, e ka mbajtur sot mbledhjen e tretë të rregullt, ku në rend dite, kishte tri pika të rendit të ditës, njëra për shqyrtimin e raportit të punës së komisionit për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve, lidhur me emërtimin e rrugëve, tjetra për ndryshimin e emrit të rrugës “Rilindja Kombëtare” me emrin e dëshmorit të kombit “Ibrahim Mazreku”, dhe pika e tretë ishte propozimi për mos furnizimin e AKP-së, me dokumentacion kadastral.

Punën e komisionit për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve, lidhur me emërtimet e rrugëve, e ka prezantuar kryetari i këtij komisioni, Rrahim Morina, sipas të cilit, pas shqyrtimeve, nuk ka kaluar asnjë propozim që nuk i ka plotësuar kriteret. Pas shqyrtimit të raportit të komisionit për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve, lidhur me emërtimin e rrugëve në Komunën e Malishevës, anëtarët e KK-së, nuk miratuan këtë raport dhe më pas e kanë shkarkuar këtë komision. Kundër këtij raporti ishin 12 anëtarë të kuvendit, për ishin 2, ndërsa 6 abstenuar.

Pikë tjetër me rëndësi, ishte propozimi i ndërrimit të emrit të rrugës “Rilindja Kombëtare” në Malishevë, me emrin e dëshmorit të kombit Ibrahim Mazreku. Ky propozim është dhënë nga anëtarja e KK-së, Arbëresha Krasniqi, e cila edhe e ka arsyetuar këtë propozim, ndërsa me shumicë të votave, ky propozim është miratuar me 16 vota, unanimitisht nga anëtarët prezent në sallë.

Po ashtu, në mbledhjen e sotme, është shqyrtuar edhe kërkesa e prezantuar nga Behije Sertolli, në emër të “komisionit për pronat e Bellanicës dhe fshatrave tjerë”, për mos furnizim me dokumentacion kadastral, për AKP-në, lidhur me pronat që AKP tenton ti likuidon, ndërsa pronat e atyre fshatrave kanë qenë private dhe kanë pasur pronar. Kjo pikë është shtyrë për një mbledhje tjetër.

Filloi fushata e repelimit të kafshëve

Malishevë, 14 mars



Sot, në territorin e Komunës së Malishevës, ka filluar fushata e repelimit të kafshëve, si masë parandaluese, në kuadër të zbatimit të strategjisë për luftimin dhe parandalimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). Repelimi i kafshëve bëhet nga Agjencioni i



Veterinës dhe Ushqimit (AVUK), realizohet nga kompania “Fauna”, ndërsa i tërë procesi mbikëqyret nga Shtabi Komunal për luftimin dhe parandalimin e EHKK.

Fushata e repelimit të kafshëve, ka filluar sot në fshatrat Senik dhe Bardh, vendbanime këto të përcaktuara nga shtabi komunal, ndërsa procesi i repelimit do të vazhdohet pa ndërprerë në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës.

Repelimit të kafshëve, e kanë inspektuar sot drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha dhe ai për bujqësi, Murat Hoxha të cilët edhe janë anëtar të shtabit komunal. Sipas drejtorit Berisha, procesi i repelimit ka filluar dhe po vazhdon mirë, pa probleme, ndërsa do të përfshihen të gjitha vendbanimet, sipas orarit të paraparë nga shtabi.

“Repelimi i kafshëve, është njëra prej masave më efektive në parandalimin e EHKK, pasi repelimi konsiderohet si njëra prej masave, e cila e ndërpret ciklin e rriqrave dhe parandalon bartjen e rriqrave nga fusha në oborre apo stalla dhe rrjedhimisht edhe kontaktin e rriqrave me njerëz”, tha Berisha.

Rriqrat janë bartës të virusit vdekjeprurës të etheve hemorragjike krime kongo, ndërsa në Komunën e Malishevës, që nga pas lufta e deri në vitin 2013, kanë vdekur 18 persona, kurse në tri vitet e fundit, nuk ka pasur vdekje, madje në vitin 2016 nuk është shënuar asnjë rast i infektimit me këtë virus. Një prej masave e cila ndikuar në uljen e këtyre rasteve, është edhe repelimi i kafshëve.

Karamarinov: FAE do të përkrahë ndërtimin e shtegut të atletikës në Malishevë

Malishevë, 15 mars

Zëvendës presidenti i Federatës Evropiane të Atletikës, Dobromir Karamarinov, ka qëndruar sot në Komunën e Malishevës, ku është pritur nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në këtë takim, i dytë i atletikës evropiane, ka premtuar përkrahjen për





ndërtimin e shtegut të atletikës në Malishevë.

Në këtë takim, mori pjesë edhe Halil Sulejmani, kryetar i Federatës së Atletikës së Kosovës, Adrian Mazreku, anëtar i kryesisë, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi.

Fillimisht, kryetari Begaj, e njoftoi të dytin e atletikës në Evropë, Karamanirov, lidhur me përpjekjet e komunës, për investime në sport dhe përkrahjen e sportistëve të rinj. “Komuna është duke u angazhuar maksimalisht, që brenda mundësive, të krijojme kushte për zhvillimin e sportit, përfshi edhe atletikën. Kemi mjaftë të rinj të cilët merren me atletikë dhe ka qenë kërkesa dhe nevoja e tyre, që ne të marrin iniciativë, për ndërtimin e shtegut të atletikës, me qëllim të zhvillimit të këtij sporti tek ne”, ka thënë Begaj.

Ndërsa, zv/presidenti i Federatës Evropiane të Atletikës, Dobromir Karamarinov, shprehi kënaqësinë e tij për vizitën e parë në Malishevë, dhe e përgëzoi komunën për këtë iniciativë, për ndërtimin e shtegut të atletikës. “Kosova ka një potencial të madh për zhvillimin e atletikës, por këtu mungon infrastruktura. Jam shumë i kënaqur që ju si komunë, kemi marrë iniciativën për ndërtimin e shtegut të atletikës dhe për këtë e keni edhe përkrahjen tonë. Federata Evropiane dhe ajo Ballanike, e Atletikës, do t’ju përkrahin në ndërtimin e shtegut”, tha zv/presidenti i Federatës Evropiane të Atletikës, Dobromir Karamarinov.

Edhe kryetari Federatës së Atletikës së Kosovës, Halil Sulejmani, shprehi falënderimin e tij, në raport me Federatën Evropiane të Atletikës, për gatishmërinë për përkrahjen e dhënë. “Ne kemi një rini shumë të shëndoshë dhe kemi nevojë për përkrahje”, tha Sulejmani.

Ka filluar ndërtimi i rrugës, që do të shërbej si transit

Malishevë, 16 mars

Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës, ka filluar rregullimi i rrugës brenda qytetit, përkatësisht nga lagja Hoti, deri në lagjen e Gurit. Kjo rrugë, do të shërbej edhe si një transit i vogël, pasi e lidh qytetin nga veriu në jug, përkatësisht dy lagjet e skajshme të qytetit.



Punimet në këtë rrugë, e kanë inspektuar edhe i pari i Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, të cilët janë ndarë të kënaqur me ecurinë e punimeve dhe nëse punimet vazhdojnë në këtë mënyrë, atëherë gjatë verës, ngasësit e automjeteve, do të kenë një mundësi më shumë për ti ikur tollovisë në qytet.

Sipas drejtorit të urbanizmit, Ahmet Morina, ndërtimi i kësaj rruge, ka një kosto prej 140 mijë eurove, ku është e paraparë edhe ndërtimi i urës mbi lumin Mirusha, ndërsa një pjesë e saj është e asfaltuar, përkatësisht në lagjen e Hotëve, në lagjen Mirëdita dhe pjesa nga hyrja në jug të qytetit, dhe tani do të hapet dhe rregullohet pjesa tjetër, e rrugës.

Njësia e shpëtimit, testoi barkën e shpëtimit dhe demonstroi shkathtësitë e veta

Malishevë, 17 mars

Sot, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe i Shpëtimit (SHZSH), në liqenin në Mirushë, ka testuar barkën e shpëtimit dhe në të njëjtën kohë edhe ka demonstruar edhe aftësitë e saj, në rastet emergjente të ndërhyrjes në ujë, përkatësisht në liqe. Pjesëtarët e njësisë së shpëtimit, kanë treguar se janë të përgatitur në rastet emergjente, për të intervenuar.

Kjo, njësi edhe më herët ka





demonstruar aftësitë e saj në liqe, përkatësisht intervenimin me barkë, mirëpo tani, falë një ndihme nga Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave (AME), janë pajisur edhe me motor për barkë, dhe tani intervenimi në rast nevojë, është shumë më i lehtë, si në liqe, ashtu edhe në rrjedhën e lumit Mirusha.

Aziz Telaku, përgjegjësi i njësisë së Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, ka konfirmuar se ky motor është dhuruar nga ana e AME-së, ndërsa do të jetë në shërbim të njësisë së shpëtimit. “Pajisja me këtë motor ka qenë shumë e nevojshme për njësinë”, tha Telaku.

Edhe zyrtarët e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Mazreku dhe Gani Kryeziu, të cilët e kanë parë nga afër këtë demonstrim, kanë thënë, se “njësia e shpëtimit është shumë mirë e përgatitur për këtë lloj të intervenimit në liqe, apo ujëra”.

Njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në Malishevë, është njëra nga krenaritet e Malishevës, pasi në shumë raste, brenda dhe jashtë Malishevës, kanë treguar rezultate shumë të mira, në intervenimet e tyre dhe janë njëra prej njësive më efikase në nivel vendi.

Po vazhdojnë vizitat sistematike shëndetësore në shkollat e Malishevës

Malishevë, 17 mars

Janë duke vazhduar vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve të klasave të para, pesta dhe të nënta. Sot ekipi i profesionistëve shëndetësor të QKMF " Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë, është duke i kryer vizitat e nxënësve të SHFMU " Hilmi Hoti" në Carrallukë. Këto vizita, sot i ka inspektuar dhe drejtori komunal për shëndetësi, Hajdin Berisha, i cili është ndarë i kënaqur me ecurinë e realizimit të vizitave.

“I tërë procesi është organizuar dhe monitoruar nga DSHMS-ja, ndërsa me sukses të jashtëzakonshëm është realizuar nga profesionistët shëndetësor të QKMF " Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë. Me këtë rast i falënderoj të gjithë drejtorët e shkollave në të cilat kanë përfunduar vizitat sistematike, për bashkëpunim dhe krijim të hapësirës dhe kushteve për profesionistët shëndetësor duke e bërë të mundur që i gjithë procesi të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme” , ka thënë drejtori komunal i shëndetësisë Hajdin Berisha.

Sipas Berishës, të hënën me datë 20.03.2017, këto vizita janë planifikuar të kryhen në SHFMU "Salih Bytyqi" në Shkozë, ndërsa këto vizita gjatë javës së ardhshme do të realizohen edhe në SHFMU " Emin Duraku" në Dragobil, në SHFMU "Ganimete Terbeshi" në Astrazup si dhe në SHFMU " Ruzhdi Xhyliqi" në Marali, me çka edhe përfundojnë vizitat sistematike.



Morina: Janë duke u realizuar dhjetëra projekte

Malishevë, 20 mars

Në Komunën e Malishevës, aktualisht janë duke u realizuar dhjetëra projekte, ku janë të përfshira më shumë se gjysma e fshatrave, ndërsa shumë shpejt do të përfshihen të gjitha vendbanimet me projekte të ndryshme. Kështu u tha në mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale, të cilën e drejton i pari i komunës, Ragip Begaj.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, në prezantimin e punës së drejtorisë, tha se “aktualisht është duke u punuar në dhjetëra projekte të ndryshme, ndërsa shumë shpejt do të fillojnë edhe projektet tjera, të cilat do ta përfshijnë çdo vendbanim. Ndërsa në infrastrukturën shkollore, deri më 1 shtator, bazuar në ecurinë e punimeve, do të jenë të gatshme katër shkolla, ajo në Bubavec, në Banjë, Astrazup dhe shkolla në Berishë”.

Kur jemi tek shkollat, drejtori i arsimit Avdi Morina, ka deklaruar se ka filluar implementimi i projektit me Karitasin Zvicëran, për pajisjen e klasave me inventar dhe mjete konkretizuese në arsimin parashkollor.

Po ashtu edhe sporti malishevas, “është duke ecur mbarë dhe ekipet që garojnë në ligat apo garat superiore, janë duke treguar rezultate, si në atletikë, në not, në volejball, por edhe në futboll dhe futsall, por për të gjitha këto duhet një mbështetje më e madhe, si nga komuna, ashtu edhe nga bizneset”, tha drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi.

Sa i përket shëndetësisë, drejtor për shëndetësi, Hajdin Berisha, ka deklaruar se “këtë javë pritet të përfundojnë vizitat sistematike shëndetësore në shkolla dhe duke u bazuar në gjendjen e deritanishme, vërehet një situatë shumë e mirë se në vitet paraprake, si në higjienë, ashtu edhe në anomali tjera të mundshme. Drejtori Berisha, foli edhe për repelimin e kafshëve, fushatë e cila është duke vazhduar mirë.

Në fushën e bujqësisë, sipas drejtorit komunal për bujqësi, këtë javë përfundojnë aplikimet për subvencione në bujqësi dhe interesimi i bujqve në Malishevë, është shumë i madh.

Edhe drejtorët e drejtorive tjera, kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e javës së kaluar dhe për planifikimet për javën në vijim, ndërsa Kryetari i Komunës, Ragip Begaj, ka kërkuar efikasitet edhe më të madh nga ana e drejtorive, në realizimin e objektivave për këtë vit.



Begaj e Basha, diskutuan për një ambient më të pastër

Malishevë, 21 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune, kryeshefin ekzekutiv të “Ekoregjionit” në Prizren, Nehat Basha, me të cilin kanë biseduar për bashkëpunimin mes komunës dhe kompanisë, për një ambient sa më të pastër dhe rritjen e aktiviteteve, për këtë qëllim.



“Një nga prioritetet në qeverisjen e komunës, është mirëmbajtja e ambientit, përkatësisht pastrimi nga mbeturinat, pasi ambienti është degraduar tej mase”, tha kryetari Begaj gjatë takimi dhe vlerësoi lartë punën e “Ekoregjionit” në Malishevë, në kryerjen e shërbimeve, për grumbullimin e mbeturinave.

Edhe kryeshefi ekzekutiv i “Ekoregjionit” në Prizren, Nehat Basha, u shpreh i kënaqur me punën e njësisë në Malishevë. “Njësia në Malishevë, është shembulli më i mirë punës si njësi, pasi janë rritur shërbimet pothuajse në të gjitha vendbanimet e komunës, e me këtë edhe vetëdijesimi i qytetarëve për këtë shërbim.

KPF, mbajti mbledhjen e katërt të radhës

Malishevë, 21 mars

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, nën drejtimin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Aziz Thaçi, ka mbajtur mbledhjen e katërt të radhës, për këtë vit, dhe ka dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës. Në mesin e këtyre rekomandimeve është draft programi komunal, trevjeçar për banim 2017-2020.

Pas shqyrtimeve, KPF ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të kuvendit, informimin e Kryetarit të Komunës, për punën e KKS-së, për vitin 2016, si dhe është rekomanduar për kuvend edhe plani i punës për vitin 2017. Po ashtu për kuvend, është rekomanduar edhe plani vjetor i njësiës së auditorit të brendshëm.



Për mbledhjen e ardhshme, janë rekomanduar edhe raporti i punës për vitin 2016, pastaj plani i punës për vitin 2017, i Qendrës për Punë Sociale në Malishevë, si dhe draft-Programi komunal trevjeçar i banimit 2017-2020, si dhe raportet e dy komisioneve që kanë të bëjnë me pronat.

Krahas këtyre rekomandimeve, për mbledhjen e ardhshme, KPF ka rekomanduar edhe katër kërkesa të qytetarëve, që kryesisht kanë të bëjnë me ndërrim destimin të tokës.

Begaj, takoi banorët e Plloqicës së Epërme

Malishevë, 22 mars

Në kuadër të takimeve me banorët e Komunës së Malishevës, i pari i komunës, Ragip Begaj, mbrëmë ka zhvilluar një takim me banorët e fshatit Plloqicë e Epërme, me të cilët ka biseduar për investimet në këtë fshat të largët, e me theks të veçantë për ndërtimin e ujësjellësit.

Kryetari Begaj, i ka njoftuar banorët e këtij fshati, lidhur me planifikimet komunale, për investime në infrastrukturën e fshatit, si dhe për investimin e përbashkët, për ndërtimin e ujësjellësit, ku është i përfshirë edhe Plloqica e Epërme, ndërsa sfidë për ndërtimin e ujësjellësit, është hapësira e përshtatshme për ndërtimin e objektit të ujëmbledhësit, për shpërndarjen e ujit në fshat.

Nga ana tjetër, banorët e fshatit, e kanë falënderuar kryetarin Begaj për vizitën, ndërsa i kanë paraqitur para tij, brengat dhe nevojat e fshatit, përderisa e kanë mirëpritur ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatin.

Begaj, priti në takim pune, zyrtarët e CMIC-ut (KFOR) italian

Malishevë, 22 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot, në një takim pune, zyrtarët e njësisë së KFOR-it italian, CIMIC, përkatësisht udhëheqësin e kësaj njësie, Ricardo Pace, i cili ishte i shoqëruara edhe nga përgjegjësit e njësisë së KFOR-it



zviceran, LMT në Malishevë. Begaj e Pace, biseduan për bashkëpunimin mes komunës dhe CIMIC-ut.

Kryetari Begaj, pasi i falënderoj për vizitën, i njoftoi ata për Komunën e Malishevës, popullatën, zhvillimin, situatën socio ekonomike, arsimin dhe për mundësit që ofron Malisheva, sidomos në fushën e bujqësisë. Ndërsa për situatën e sigurisë, Begaj tha se “jemi rajoni më i qetë në vend, dhe rajoni më së paku probleme në fushën e sigurisë së përgjithshme”.

Edhe udhëheqësi i CIMIC-ut italian, Ricardo Pace, e konfirmoi se Malisheva është një rajon i qetë në fushën e sigurisë së përgjithshme, pasi këtë e konfirmojmë edhe organet përgjegjëse, ndërsa vlerësoi lartë bashkëpunimin e komunës me KFOR-in italian. Ushtaraku Pace, ka konfirmuar se shumë shpejt, CIMIC-u italian, do të ndihmoj një shkollë me kompjuter, për kabinet të informatikës, pasi paraprakisht e kishte marrë këtë kërkesë nga ana e drejtorit të të arsimit në Malishevës, Avdi Morina dhe kjo kërkesë është drejt realizimit.

Begaj dhe Pace, vlerësuan lartë bashkëpunimin e ndërsjellë dhe u zotuan për vazhdimin e këtij bashkëpunimi mes organeve të KFOR-it dhe Komunës së Malishevës.

Kryetari Begaj, vizitoi tregun në Malishevë

Malishevë, 23 mars



Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga drejtori për shëndetësi dhe mirëqenies sociale, Hajdin Berisha, kanë vizituar sot tregun e gjelbër në Malishevë, me qëllim të njoftimit nga afër me blerësit dhe shitësit në treg, me të cilët kanë biseduar për shitjen dhe blerjen e artikujve të ndryshëm. Dita e enjte, është ditë tregu në Malishevë.

Kryetari Begaj, gjatë kësaj vizite, është takuar me shumë blerës dhe shitës në treg, me të cilat ka biseduar me problemet që ata përballen në treg, pastaj arsyeshmëritë e çmimeve dhe mundësitë që kanë blerësit.



E veçanta e këtij lloji të shitblerjes, janë produktet vendore të cilat dominojnë, pasi shumica e shitësve, produktet që i shesin janë produkte të cilat kultivohen në kopshtet apo serrat e tyre, ndërsa edhe blerësit e kanë mundësinë, që krahas çmimeve më të arsyeshme, të blejnë edhe produktet vendore.

Në këtë periudhë të vitit, produktet të cilat më së shumti janë prezent në treg, janë perimet dhe rasatet e tyre, pastaj fidanet e pemëve të ndryshme, si dhe prodhimet e tjera ushqimore, duke mos munguar as produktet artizanale, të prodhuesve vendor, duke u nisur nga veshjet kombëtare dhe veglat muzikore, e deri te prodhimet tjera.

Sot, përfunduan vizitat sistematike shëndetësore në shkollat e Malishevës

Malishevë, 23 mars



Sot edhe zyrtarisht mbyllet procesi i vizitave sistematike shëndetësore në shkollat e Komunës së Malishevës. Për këtë qëllim, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Azizi Thaçi dhe drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Hajdin Berisha, e kanë vizituar shkollën në Marali, ku edhe ka përfunduar ky projekt në fushën e shëndetësisë.

Kryetari Begaj, i ka takuar mjekët dhe teknikët shëndetësor të angazhuar në këtë projekt, të cilët i ka përgëzuar për këtë punë të lodhshme dhe të vështirë, por që është në shërbim të shëndetit të fëmijëve. Kryetari Begaj, është njoftuar nga mjekët, për ecurinë e këtij procesi.

Edhe kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaci dhe drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, i kanë përgëzuar punëtorët shëndetësor, për përmbylljen e këtyre vizitave shëndetësore. “Unë shfrytëzoj rastin ti falënderoj të gjithë punëtorët shëndetësor për përfundimit të këtij procesi dhe në mënyrë të veçantë i falënderoj të gjithë drejtorët e shkollave, për bashkëpunim dhe krijimin e kushteve të nevojshme, për realizimin e vizitave shëndetësore”, tha drejtori komunal për shëndetësi, Hajdin Berisha.

Sipas punëtorëve shëndetësor të angazhuar në këtë proces, këtyre vizitave, i janë nënshtruar rreth 3500 nxënës, në të gjitha shkollat, ndërsa këtë vit është vërejtur një përmirësim i dukshëm i



higjienës, e sidomos i kujdesit oral. Ekipi i cili e ka realizuar këtë projekt, thanë se shumë shpejt, pasi të përpunohen të gjitha të dhënat e marra nga vizitat, do të dilet me një raport përfundimtar, lidhur me gjendjen shëndetësore të nxënësve, të cilët i janë nënshtruar këtyre vizitave.

Hoxha: Gratë fermere do të kenë përparësi në subvencionet e komunës

Malishevë, 23 mars



Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Malishevës, Murat Hoxha, së bashku me grupin joformal të grave asmabliste në KK të Malishevës, sot kanë vizituar disa nga gratë fermere dhe mbajtëse të familjeve, ku janë njoftuar me punët në fermat e tyre, ndërsa drejtori Hoxha, ka premtuar se gratë fermere, do të kenë mbështetjen e komunës, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre në bizneset e vogla familjare.

Drejtori Hoxha dhe grupi jo formal i grave, i kanë vizituar gratë fermere, në Turjakë, Gurishtë, Banjë dhe Bellanicë, ku në mesin e tyre ishin edhe përfaqësuese të dy shoqatave të grave të cilat merren me kultivimin e kulturave bujqësore.

Gjatë bisedave me këto gra fermere, është vërejtur një përkushtim i tyre në kultivimin e kulturave bujqësore, ndërsa vet gratë të cilat sot janë vizituar, e kanë

falënderuar Komunën e Malishevës, përkatësisht Drejtorinë për Bujqësi, për vizitën e sotme dhe për përkrahjen e vazhdueshme, për zhvillimin e bizneseve të tyre familjare.

“Përmes kësaj përkrahje nga ana e komunës, ne arrijmë të zhvillojmë punën tonë dhe përmes kësaj, bëhet edhe fuqizimi i gruas në biznes dhe në shoqëri në përgjithësi”, thanë gratë fermere të Komunës së Malishevës.



Begaj: Do ti përkrahim organizimet sportive në shkolla

Malishevë, 24 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i arsimit Avdi Morina dhe drejtoresha për sport, Blerta Krasniqi, kanë pritur sot në një takim pune, kryetarin e Federatës së Sportit Shkollorë të Kosovës, Adrian Telaku dhe udhëheqësin e divizionit të sportit shkollor të kësaj federate, Fikret Shatrin, me të cilët kanë biseduar për organizimin e garave sportive shkollore në Komunën e Malishevës. Me këtë rast, kryetari Begaj, ka premtuar përkrahjen e komunës, për organizimin e këtyre garave.

“Ne si komunë, mundohemi ti përkrahim këto aktivitete, brenda mundësive buxhetore të komunës, sikur edhe aktivitetet tjera sportive, si dhe investimet në sportin e Malishevës, me qëllim të zhvillimit të sportit dhe edukimit të të rinjve. Dëshiroj të kemi bashkëpunim të mirë me federatën tuaj, në të mirë të zhvillimit të sportit shkollorë”, ka thënë Begaj, duke premtuar vazhdimin e përkrahjes së komunës, në organizimin e këtyre garave.

Drejtori i arsimit, Avdi Morina, tha se “drejtoria që drejton, do të përkrahë këto aktivitete sportive, të cilat janë edhe edukative dhe i mbajnë të rinjtë larg dukurive negative”. Edhe drejtoresha e sportit, Blerta Krasniqi, tha se “do ta kenë në dispozicion tërë infrastrukturën sportive në Malishevë, për organizimin e këtyre aktiviteteve”. “Në tri vitet e fundit, i kemi përkrahur këto aktivitete sportive, prej ku edhe kanë dalë talent në sportet e ndryshme, dhe jemi shumë të kënaqur me sukseset e treguara nga nxënësit dhe shkollat tona”, tha drejtoresha Krasniqi.

Se nga organizimi i këtyre garave, kanë dalë talent nga Komuna e Malishevës, e ka konfirmuar edhe vet kryetari i kësaj federate, Adrian Telaku. “Malisheva gjithmonë i ka përkrahur këto gara, dhe rezultatet kanë qenë të mira, pasi kanë shumë talent, të cilët përfaqësojnë denjësisht klubet ku janë angazhuar”, tha Telaku.

Ndërsa, Fikret Shatri, ka sqaruar mënyrën e organizimit të këtyre garave, ku sipas tij, garat në nivelin komunal, duhet të përkrahen nga vet komunat, kurse ato në niveleve regjionale dhe nivelit shtetërorë, organizohen dhe mbulohen nga federata.

Asfaltohen rrugët në Pagarushë



Malishevë, 24 mars

Sot, ka filluar asfaltimi i rrugëve në fshatin Pagarushë, përkatësisht në lagjet Dukoj dhe Rexhaj. Asfaltimin e këtyre rrugëve, krahas banorëve të fshatit, e ka parë nga afër edhe drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm , Ahmet Morina, i cili ka uruar banorët e këtyre lagjeve, ndërsa është ndarë i kënaqur me punimet në këto rrugë.

“Para një muaji kemi filluar hapjen dhe rregullimin e rreth 700 metrave rrugë në këtë fshat, ku janë hapur rrugët, është rregulluar baza dhe sot po asfaltohen”, tha Morina. “Edhe atëherë kam thënë se kjo nuk është thjesht një asfaltim i rrugës, por është krijimi i kushteve sa më të mira për të gjithë banorët, dhe rrjedhimisht edhe për lëvizjen e qytetarëve”, tha drejtori Morina.

Nga ana tjetër, banorët e fshatit, e kanë falënderuar komunën për hapjen dhe rregullimin e këtyre rrugëve, pasi shumë shtëpi të këtyre lagjeve, kanë pasur problem serioz lëvizjen e tyre, sepse rrugët kanë qenë në gjendje tepër të vështirë, e sidomos kanë pasur problem gjatë stinëve kur ka të reshura të borës dhe shiut.

Fshati Pagarushë, është një prej fshatrave të largëta të Komunës së Malishevës, dhe është një fshat ku lagjet janë shumë larg njëra tjetrës, ndërsa disa pjesë të këtyre lagjeve, kanë pasur problem qarkullimin, apo lidhjen e rrugëve të tyre, me rrugët kryesore, që shpijnë drejt qendrës komunale, apo qendrave tjera.

Ka filluar pastrimi i një dege të lumit Mirusha

Malishevë, 27 mars

Ka filluar gjatë vikendit dhe është duke vazhduar edhe sot, pastrimi i përroskës, degë e lumit Mirusha, që kalon në një pjesë të qytetit të Malishevës. Kjo përroskë, është një kanal i madh shkarkues u ujërave, që vijnë nga Malet e Berishës dhe derdhet në lumin Mirusha, ndërsa gjatë shirave, disa herë ka pasur edhe përmbytje, si pasojë e bllokimit për shkak të hedhjes së mbeturinave.

Punimet në pastrimin e kësaj dege të lumit, i ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i shoqëruar edhe nga drejtorët përgjegjës. Nënkryetari Mazreku, me këtë rast, ju ka bërë thirrje qytetarëve që to mos i gjuajnë mbeturinat në të, sepse, krahas erës së keqe, po shkaktohen edhe përmbytje.



Drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka bërë të ditur së pastrimi i kësaj dege të lumit, ka filluar gjatë vikendit dhe është duke u punuar pandërprerë në pastrimin e tërësishëm të saj, duke filluar nga hyrja në Malishevë, e deri në lidhjen e saj në lumin Mirusha.

Nesër fillojnë ligjëratat mbi mbrojtjen nga thumbimi i rriqrave

Malishevë, 27 mars

Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik për Parandalimin dhe Luftimin e EHKK, prej nesër në organizim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, fillojnë ligjëratat në shkolla. Realizimin e këtij aktiviteti e kryen stafi i profesionistëve shëndetësor të QKMF " Dr. Shpëtim Robaj" në Malishevë.

Për nesër, pra me datë 28.03.2017, ligjëratat janë planifikuar të mbahen në SHFMU " Ibrahim Mazreku" në Malishevë, ka bërë të ditur drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha. Berisha, paraprakisht, i ka falënderojmë drejtorët e shkollave për përkrahjen e këtij aktiviteti.

Asfaltohet rruga që lidhë fshatrat Marali dhe Maxharrë

Malishevë, 27 mars



Sot, ka filluar asfaltimi i rrugës që lidhë fshatrat Marali dhe Maxharrë. Ky projekt realizohet në kuadër të përpjekjeve të Komunës së Malishevës, për rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme, e në veçanti në kuadër të krijimit të kushteve më të mira për lëvizjen e qytetarëve, në rastin konkret, të banorëve të dy fshatrave.

Gjatë asfaltimit të kësaj rruge, ishte prezent edhe drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, i cili e ka inspektuar asfaltimin e rrugës, si dhe është takuar me banorët e të dy fshatrave, të cilët i ka uruar për rrugën që i lidh këto dy fshatra.



Banorët e fshatrave Marali dhe Maxharrë, e kanë falënderuar Komunën e Malishevës, për rregullimin e kësaj rruge, e cila edhe pse nuk është shumë e gjatë, ajo ju kursen disa kilometra banorëve, për të shkuar nga njëri fshat në tjetrin.

Filloi ndërtimi i urës mbi lumin Mirusha

Malishevë, 30 mars



Në kuadër të ndërtimit të rrugës unazore, e cila kalon mbi lumin Mirusha, sot ka filluar ndërtimi i urës mbi këtë lum. Në ceremoninë e fillimit të ndërtimit të urës mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, bashkë me drejtorët e disa drejtorive komunale, punë kryesi dhe qytetarë të tjerë.

Ndërtimi i urës, ka rëndësi të madhe, jo vetëm për shkak të kësaj

rruge unazore, por edhe për të gjithë banorët e qytetit të Malishevës, pasi banorët e disa lagjeve nuk kanë nevojë të kalojnë nëpër qendër të qytetit, për shkuar nga lagjja në lagje, por tani do të lëvizin më shkurt dhe më shpejt.

Përndryshe, sipas drejtorit të urbanizmit, Ahmet Morina, kjo urë ka një gjatësi prej 17 metrave dhe një lartësi prej mbi shtatë metrave, ndërsa i tërë projekti i ndërtimit të urës dhe rrugës unazore, ka një shumë prej rreth 140 mijë euro dhe financohet nga buxheti komunal i Malishevës.

Asfaltohen rrugët në disa lagje të Banjës

Malishevë, 30 mars

Sot ka filluar asfaltimi i rrugëve në disa lagje të fshatit Banjë, të cilat edhe pse janë





lagje të mëdha, deri më tani kanë qenë me rrugë të paasfaltuara. Në punimet e asfaltimit të rrugëve mori pjesë edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina. Me këtë rast, nënkryetari Mazreku, i ka uruar banorët e këtyre lagjeve, për rregullimi i rrugëve.

Edhe banorët e kanë falënderuar nënkryetarin Mazreku dhe Komunën e Malishevës, për rregullimin e rrugëve në lagjet e tyre. Nuhi Shala, anëtar i kryesisë së fshatit Banjë, tha se “Banja, si njëri nga fshatrat më të mëdha, ka shumë nevoja për rregullimin e infrastrukturës, ndërsa rregullimi i rrugëve në lagjet e Telakëve, Begajve dhe Hazrollëve, ka qenë mëse i nevojshëm, pasi asnjëherë në këto lagje nuk është investuar në infrastrukturën rrugore”.

Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, tha se “këto rrugë që sot po asfaltohen, janë pjesë e projekteve, të cilat janë miratuar në Kuvendin e Komunës dhe komuna është duke i realizuar këto projekte, në të gjitha fshatrat, dhe këto janë pjesë e planifikimeve komunale, për rregullimin e tërësishëm të infrastrukturës rrugore, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për të gjithë banorët e Komunës së Malishevës”.

Banja, është një prej vendbanimeve më të mëdha në Komunën e Malishevës, si dhe është një prej vendeve më turistike në vend, sidomos gjatë stinës së verës, për shkak të pishinave natyrore, me ujë termal dhe ujë shërues.

U përkujtua masakra e Burimit

Malishevë, 31 mars

Përmes homazheve në vendin e vrasjes dhe në varrezat e martirëve, sot është përkujtuar masakra më e madhe në Malishevë, ajo e Burimit, ku u vranë e u masakruan 42 civil, kryesisht të fshatrave Dragobil dhe Astrazup, si dhe banorë të fshatrave të Suharekës. Me këtë rast, homazhe kanë bërë, familjarët dhe të afërmit e të vvarëve, Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, Aziz Thaci, zyrtarë të qeverisë komunale, anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe zyrtarët të të gjitha subjekteve politike në Malishevë.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e sotme të rregullt, ka mbajtur një minutë heshtje, në nderim të të gjithë të vvarëve në këtë masakër.

Masakra e Burimit, është masakra më e madhe në Komunën e Malishevës. Më 31 mars të vitit 1999, janë vvarë, janë djegur, e më pas janë masakruar 42 civil, disa prej tyre edhe sot e kësaj dite nuk janë identifikuar.



Për këtë krim të organizuar, edhe sot pas tetëmbëdhjetë viteve nuk është dënuar askush dhe nuk është ngritur asnjë padi.

Kryetari Begaj, priti një grup biznesmenësh nga Ankaraja

Malishevë, 31 mars

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim pune një grup biznesmenësh nga Turqia, përkatësisht nga Ankaraja, me të cilët ka biseduar për mundësitë e investimeve në Malishevë, me theks të veçantë për trajtimin ujërave të zeza, apo ngritjen e impianteve, si dhe për mundësitë e investimeve në fushat tjera.

Fillimisht, kryetari Begaj, i ka njoftuar përfaqësuesit e bizneseve turke, lidhur me gjendjen e përgjithshme në Komunën e Malishevës, si dhe për mundësitë që ofron Malisheva, për investitorët, në të gjitha fushat.

Nga ana tjetër, biznesmenët turq, u interesuan për kushtet dhe mundësitë e investimeve, të cilat do të jenë në harmoni me projektet, idetë dhe nevojat që ka, në këtë rast Malisheva.

Përveç trajtimit të ujërave, bizneset turke, janë të interesuar edhe për investime ne fushën e energjisë, përmes sistemit të përfitimit të energjisë solare.